

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P. Nr.: 279/2012

Data: 28 qershor 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në PRISHTINË me Trupin Gjykes të përbërë nga Gjykatësi nga EULEX Vitor Hugo Pardal në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykes, Gjykatës nga EULEX Jonathan Welford-Carroll dhe Gjykatës vendor Hava Haliti si anëtarë të Trupit Gjykes, të asistuar nga Bashkëpunëtori Profesional nga EULEX Clemens Mueller dhe Proces-Mbajtësi Jacqueline Ryan në lëndën penale ndaj:

B.D; SH.D; I.B; SH.H; R.GJ.

Sipas vendimit për konfirmim të nxjerrë më 25 nëntor 2011, tre të parët të akuzuar me **marshtrim** në kundërshtim me nenin 261, paragrafët 1 dhe 2 KPK, **lidhja e kontratave të dëmshme** në kundërshtim me nenin 237, paragrafët 1 dhe 2, KPK dhe **falsifikim i dokumenteve në raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve**, në kundërshtim me nenet 332, paragrafi 1 dhe 333, paragrafi 3, KPK, që të gjithë në bashkë-kryerje lidhur me nenin 23 të instrumentit të njëjtë ligjor.

Dy të pandehurit e fundit të identifikuar janë ngarkuar me **lidhje të kontratave të dëmshme** në kundërshtim me nenin 237, paragrafët 1 dhe 2, KPK, që të gjithë në bashkë-kryerje lidhur me

nenin 23 të instrumentit të njëjtë ligjor si dhe secili prej tyre me **shpërdorim të pozitës zyrtare** në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1 deri 3, KPK.

Me të mbajtur 17 seanca të hapura për publikun, më 31 korrik 2012, 15, 16, 17 dhe 23 tetor 2012, 22 janar 2013, 20 dhe 21 mars 2013, 16, 23, 24, 27 dhe 31 maj 2013 dhe 25, 26, 27 dhe 28 qershor 2013 në prani të të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës Z. V.I., Z. B. G. Ch., Z. G. T., Z. A. F., Znj. I. O., Z. R. G., Z. A. R., Z. B. P. dhe Z. H. H., së bashku me prokurorët nga PSRK Z. Joachim Stollberg dhe Z. Charles Hardaway, palët e dëmtuara xxx, xxx dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, përkatësisht M.G. dhe L.S..

Pas pleqërimit të Trupit Gjykes dhe votimit të mbajtur më 27 qershor 2013, në pajtim me nenet 388.1 dhe 390.3, KPPK, nxjerrë si në vijim

AKTGJYKIM

Pika 1 – Mashtrim në kundërshtim me nenin 261, paragrafët 1 dhe 2, KPK, si në vijim:

“I.B, i punësuar në mes të 21 dhe 25 nëntor 2008 si përfaqësues ligjor i Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC, me një marrëveshje të fshehtë me dhe nën mbikqyrjen e B.D. dhe Sh.D., ushtroi një kërkesë në Agjencinë Rregullative të Telekomunikacionit (ART) në Prishtinë më 25 nëntor 2008 për transferin e licensës së Operatorit të Rrjetit Mobil Virtual (MVNO) nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC pavarësisht dijenisë së tij të përgjithshme mbi strukturën e aksionerëve në Dardafon LLC. Ai në mënyrë të rremë ka pretenduar tek vendim-marrësit e ART-së se transferi i licensës ka qenë i bazuar në dijeninë dhe marrëveshjen me shumicën e aksionerëve në Dardafon LLC, Unitel World dhe xxxin, A.Sh. as nuk e ka ditur se një transfer i tillë i licensës së MVNO-së do të bëhet dhe as nuk është pajtuar që licenca të transferohet në Dardafon.net LLC. Për shkak të kërkesës së rreme të I.B, ART-ja transferoi licensën e MVNO-së me besim të plotë nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC, gjë e cila rezultoi në humbjen e licensës nga Dardafon LLC për të cilën kishte investuar 50.000,00 Euro. Prandaj, vlera financiare tejkaloi shumë prej 15,000.00 Euro.”

Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, KPPK, të akuzuarit B.D, SH.D dhe I.B me të dhënat personale si më lart, që të gjithë

LIROHEN.

Për shkak se në rastin konkret nuk është vërtetuar se ndonjë nga të akuzuarit kanë kryer veprat

penale me të cilat ngarkohen.

Pika 2 – Lidhja e kontratave të dëmshme në kundërshtim me nenin 237, paragrafët 1 dhe 2, KPK, si në vijim:

“Pavarësisht se e ka ditur nga arsyeja e fakteve të përshkruara nën pikën 1 1 se Dardafon LLC do të humbaste licensën MVNO, I.B me urdhrin dhe nën mbikqyrjen e B.D dhe Sh.D, përpiloi, nënshkroi dhe dorëzoi kërkesën në ART. Duke pasur parasysh se Kompania xxx ishte pakicë e aksionerëve në Dardafon LLC, pasi që Sh.D ishte xxx i 90% të Dardafon.net LLC, B.D dhe Sh.D fituan kontroll faktik mbi licensën e MVNO-së duke bërë që të transferohej ajo në Dardafon.net LLC, duke shkaktuar kështu dëmtim serioz për Dardafon LLC”

Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, KPPK, të akuzuarit B.D, SH.D dhe I.B që të gjithë

LIROHEN

Sepse në rastin konkret nuk është vërtetuar se ndonjë prej të akuzuarve kanë kryer veprimet me të cilat ngarkohen.

Pika 4 –rast i posaçëm i falsifikimit të dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332, paragrafi 1 dhe 333, paragrafët 1 dhe 3, KPK, si në vijim:

“B.D, Sh.D dhe I.B në një kohë dhe vend të papërcaktuar më 2008 apo 2009, ndikuan në përpilimin e formulimit të marrëveshjes përfundimtare MVNO, të datuar 16 janar 2009 në mes XXX dhe Dardafon.net LLC, apo vetë përpiluan formulimin pavarësisht djenisë se fakte të rreme përfshihen në këtë dokument. Marrëveshja deklaroi se Dardafon.net LLC arriti një “parakontratë” në gusht 2008 me XXX, ndërsa në realitet kjo “parakontratë” është arritur në mes të Dardafon LLC dhe XXX. Dardafon.net LLC nuk ekzistoi deri në gusht të vitit 2008. Marrëveshja përfundimtare MVNO është përpiluar si specifikim dhe zhvillim i mëtutjeshëm i “parakontratës”si pjesë integrale e marrëveshjes MVNO.”

Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, KPPK, të akuzuarit B.D, SH.D dhe I.B që të gjithë

LIROHEN

Për shkak se në rastin konkret nuk është vërtetuar se ndonjë prej të akuzuarve kanë kryer veprimet me të cilat ngarkohen.

Pika 6 – Lidhja e kontratave të dëmshme në kundërshtim me nenin 237, paragrafët 1 dhe 2, KPK, si në vijim:

“Më 20 tetor 2008 në Prishtinë, në takimin e Bordit të Drejtorëve në XXX, R.Gj si xxx

në XXX qëllimisht votoi në favor dhe pa ndonjë hezitim që XXX-ja të lidhë marrëveshje MVNO me Dardafon.net LLC. Aprovimi parashikoi se Dardafon .net LLC si MVNO ka të drejtë të përdorë burimet e telekomunikacionit të XXX-së dhe si shkëmbim ka për obligim të paguajë ndarje të fitimit në shumën prej 22%. R.Gj e dinte se marrëveshje përfshinte një ndarje të papranueshme sa i përket ndarjes së fitimit dhe mungesë të sigurimeve të mjaftueshme për XXX-në, dhe se bazohet në propozim për ndarje të fitimit, gjë të cilën Bordi më parë e kishte hedhur poshtë. R.Gj ishte forca shtytëse në Bordin e XXX-së që të aprovohet marrëveshja MVNO me ndarjen e pafavorshme të fitimit dhe përmbajtjen e pasigurtë.

Sh.H si xxx në XXX që nga 14 dhjetori 2008, nënshkroi marrëveshjen përfundimtare me MVNO, datuar 16 janar 2009, në mes XXX dhe Dardafon.net LLC, duke e ditur se marrëveshja do të shkaktonte humbje financiare për XXX në shumën e pallogaritshme duke tejkuluar atë prej 100.000,00 Euro. Sh.H nënshkroi çdo faqe të marrëveshjes MVNO në mes të Dardafon.net LLC dhe XXX, përfshirë Aneksin 7, i cili përmbante “parakontratën” në mes të Dardafon LLC dhe XXX, duke shkelur kështu obligimet e parakontratës me Dardafon LLC. Për më tepër, Sh.H pavarësisht se ishte në dijeni për pafavorshmërinë dhe pasigurinë, nënshkroi marrëveshjen MVNO me ndajre të fitimit 27% në dëm të XXX-së, duke i shkaktuar kështu XXX-së dëmim të rëndë. Ai e bëri këtë duke i ditur rekomandimet për të kundërtën nga ana e të ashtuquajturës Task Force 2, të nisur nga Bordi i Drejtorëve për të gjetur një ndarje më fitimprurëse për XXX-në. Task Force 2 erdhi te rezultati se ndarja prej të paktën 73% në favor të XXX-së ishte e pranueshme për të parandaluar humbjet”.

Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, KPPK, të akuzuarit SH.H dhe R.GJ me të dhënat personale si më lart, që të dy

LIROHEN

Për shkak se në rastin konkret nuk është vërtetuar se ndonjë nga të akuzuarit kanë kryer veprimet për të cilat ngarkohen.

Pika 7 – shpërdorim i pozitës zyrtare në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1, 2 dhe 3, KPK, si në vijim:

“Sh.H nënshkroi marrëveshjen e përshtuar në pikën 6 duke e ditur se në aspektin financiar, kontrata është e pafavorshme për XXX-në dhe shkelë obligimet parakontaktuale ndaj Dardafon.net LLC. Ai ka lidhur një marrëveshje të tillë duke shkelur obligimet e tij si xxx duke pranuar presion nga burime të jashtme për të nënshkruar marrëveshjen MVNO në vend se t’u nënshkruajë atë bazuar në detyrat e tij që kishte në mirëbesim kundrejt XXX-së. Për shkak se H. nënshkroi marrëveshjen me Dardafon.net LLC dhe jo Dardafon LLC, kjo gjë shkaktoi dëme për Dardafon LLC duke tejkuluar shumën prej 2,500.00 Euro dhe pajisi Dardafon.net LLC me përfitim financiar me shumën që tejkalon atë 5.000,00 Euro”.

Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, KPPK, i akuzuari SH.H.

LIROHET

Për shkak se në rastin konkret nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprimet me të cilat ngarkohet.

Pika 10 – **shpërdorim i pozitës zyrtare** në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1, 2 dhe 3, KPK, si në vijim:

“R.Gj duke ushtruar presion re Bordi i Drejtorëve në XXX në tetor 2008 në Prishtinë për të aprovuar kontratën e lartëpërmendur MVNO, ai tejkaloi autoritetin e tij si xxx duke ushtruar ndikim të pabazuar tek anëtarët e bordit duke e ditur se marrëveshja MVNO ishte e pafavorshme dhe se shumica e anëtarëve të bordit para 20 tetorit 2008 nuk e kanë mbështetur mendimet e Task Force 1, R.Gj. me kaq i ka dhënë Dardafon.net LLC përfitim material, i gjë e cila nuk ishte reflektim i mendimit të pandikuar të shumnicës së bordit të drejtorëve. Edhe pse një anëtar i bordit ka dhënë mbështetjen e tij për marrëveshjen MVNO me një rishqyrtim të mëtutjeshëm të nivelit të përqindjes në ndarjen e fitimit, ky përkufizim është injoruar nga Gj. dhe nuk është reflektuar në vendimin e bordit.”

Në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, KPPK, i akuzuari R.GJ. me kaq

LIROHET

Për shkak se në rastin konkret nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprimet me të cilat ngarkohet.

Në pajtim me nenin 103, paragrafi 3, KPPK burimet e bugjetit do të mbulojnë shpenzimet e kësaj procedure penale siç parashihet me nenin 99, paragrafët 1 dhe 2, nënparagrafët 1 deri 5.

ARSYETIMI

Prapavija procedurale

Më 8 qershor 2011, Prokurori nga PSRK Z. Joachim Stollberg ngriti aktakuzë ndaj 5 individëve, B.D, Sh.D, I.B, Sh.H dhe R.Gj me pikat e akuzës për mashtrim, në kundërshtim me nenin 261.1 dhe 2, KPK (pika 1), lidhja e kontratave të dëmshme, në kundërshtim me nenin 237.1 dhe 2, KPK (pika 2), keqpërdorimi besimit, në kundërshtim me nenin 269.1, KPK (pika 3), rast i posaçëm i falsifikimit të dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332.1 dhe 3 dhe 333.1, KPK (pika 4), krim

i organizuar, në kundërshtim me nenin 274.1 deri 3, KPK (pika 5), me të cilat janë akuzuar tre të pandehurit e parë në bashkë-kryerje, sipas nenit 23, KPK. Në mbështetje të këtyre akuzave, Prokurori nga PSRK-ja ofroi prova në dokumente (faqe 47 deri 50 të aktakuzës), 21 dëshmitarë (faqe 46 dhe 47), dhe 1 dëshmitar ekspert (faqe 46).

Provat e njëjta janë ofruar në mbështetje të akuzës për lidhje të kontratëve të dëmshme, në kundërshtim me nenin 237. 1 dhe 2, KPK (pika 6) me të cilin janë akuzuar i pandehuri i katërt dhe ai i pestë në bashkë-kryerje, sipas nenit 23, KPK si dhe me shpërdorim të pozitës zyrtare, në kundërshtim me nenin 339.1 deri 3, KPK (pika 7) dhe keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi, në kundërshtim me nenin 236.1.5 dhe 2, KPK (pika 8) lidhur me të pandehurin Sh.H, dhe keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi, në kundërshtim me nenin 236.1.5 dhe 2, KPK (pika 9) dhe shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit, në kundërshtim me nenin 339.1 deri 3, KPK (pika 10) lidhur me të pandehurin R.Gj.

Më 25 nëntor 2011, gjykatësi për konfirmim lëshoi vendim për konfirmim duke hedhur poshtë pikat e lartpërmendura të akuzës 3, 5, 8 dhe 9, gjë e cila tanimë është konfirmuar me vendimin e kolegjit ankimor të datuar 22 mars 2012.

Procedura e rregullt është ndjekur në këtë lëndë me shqyrtim kryesor.

Shtatëmbëdhjetë seanca të hapura për publikun janë mbajtur më 31 korrik 2012, 15, 16, 17 dhe 23 tetor 2012, 22 janar 2013, 20 dhe 21 mars 2013, 16, 23, 24, 27 dhe 31 maj 2013 dhe 25, 26, 27 dhe 28 qershor 2013, me aktgjykimin që shpallet verbalisht në seancën e fundit.

Disa vendime janë nxjerrë dhe këto janë si në vijim: a. Kërkesa e mbrojtjes për zbulim, , e datuar 25 korrik 2012, e vendosur më 31 gusht 2012; b. Kërkesa e mbrojtjes për përjashtim nga funksioni në shqyrtim, datuar 25 korrik 2012, e vendosur më 31 korrik 2012; c. Kërkesa e

mbrojtjes për të përjashtuar prova, e vendosur më 31 gusht 2012; d. Kërkesa e mbrojtjes për ndryshimin e caktimit të datave për seancë, e vendosur më 31 gusht 2012; e. Kërkesa e mbrojtjes për të ndarë procedurën, e vendosur më 31 korrik 2012 dhe 31 gusht 2012; f. Kërkesa e mbrojtjes dhe e prokurorit për të shtyer shqyrtimin kryesor për shtator 2012, datuar 21, 24 dhe 27 qershor dhe 26 qershor 2012, dhe vendosur më 31 korrik 2012; g. Kërkesa e prokurorisë për të emëruar dëshmitar ekspert, e ushtruar më 18 maj 2012 dhe e vendosur më 31 gusht 2012; h. Urdhri për ekspertizë nga kolegji i emëruar prej ekspertëve, e vendosur më 14 nëntor 2012 pas vendimit të datës 31 gusht 2012 mbi procedurën e mëparshme të tenderit; vendimi për kërkuesin për të dorëzuar dokumente kolegjit prej ekspertëve, datuar 12 mars 2013; i. Vendimi ndaj kërkesës së mbrojtjes mbi aktgjykimin lirues, datuar 28 maj 2013.

Të pandehurit Sh.H dhe R.Gj kanë dhënë deklaratë në shqyrtimin kryesor në pajtim me nenin 372 të KPPK-së. Të gjithë të pandehurit kanë paraqitur fjalë përfundimtare vetë (Sh.H dhe R.G) apo përmes avokatëve të tyre respektivë. Për më tepër, të dy palët e dëmtuara dhe Prokurori i PSRK-së paraqitën fjalët e tyre përfundimtare.

Të gjithë të pandehurit ishin të pranishëm gjatë shpalljes së aktgjykimit përfundimtar.

Jurisdiksioni i kësaj Gjykate

Gjyqtarët që përbëjnë këtë trup gjykues janë kompetentë për të gjykuar këtë lëndë dhe gjykatë ka jurisdiksion material dhe territorial në pajtim me nenin 33 KPK dhe nenin 21 dhe 23.1.i) të KPPK-së. Pas një vendimi nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it lëshuar më datë 22 maj 2012 me anë të të cilit gjyqtarët e nënshkruar të EULEX-it janë caktuar për të gjykuar këtë lëndë, është caktuar gjyqtari vendor bazuar në planin e punës në fuqi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Janë mbajtur shtatëmbëdhjetë seanca të shqyrtimit kryesor dhe palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e trupit gjykues apo jurisdiksionin e kësaj gjykate. Për këtë

arsye trupi gjykues është kompetent për të shqyrtuar këtë lëndë në pajtim me nenin 3.1 LJ (Ligji 03/L-53).

Provat e Administruara

Provat në vijim janë vlerësuar relevante për diskutimet përfundimtare dhe nxjerrjen e aktgjykimit.

Provat me shkrim: Lista në vijim e provave të dokumentuara është marrë parasysh në shqyrtimin kryesor:

- Agjensia Kosovare e Regjistrimit të Bizneseve, informata lidhur me biznesin Dardafon.net LLC, xxx company;
- Deklarata e veprimit, procesverbalet e takimeve organizative të K-Com group;
- Artikulli nga gazeta Koha Ditore, datë 28 shtator 2010;
- Marrëveshja për konsultim dhe këshillim mes Dardafon LLC dhe Evere, datë 27 mars 2008;
- Aplikimi për licensë i Dardafon datë 29 tetor 2007;
- Vlerësimi i aplikimit dhe verifikimi në takimin e bordit të ART-së datë 29 maj 2008;
- Dhënia e licensës MVNO nga ART kompanisë Dardafon LLC, datë 12 qershor 2008;
- Kërkesa ART për pagesë, pagesa e shumës prej 50.000 Euro për licensë
- Aplikimi i LLC pranë ART për transferim të licensës datë 25 nëntor 2008;
- Takimi i bordit ART datë 5 dhjetor 2008;
- Vendimi i ART-së për transferimin e licensës tek Dardafon.net, datë 10 dhjetor 2008;
- Regjistrimi i Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC;

- Letra të Zt. A.Sh XXX-së dhe përgjigje, datë 2009;
- Letër nga Zt. B.D XXX-së duke informuar për pronësi të vetme dhe marrëveshje mbi transferimin e aksioneve, shtator 2009;
- Pasqyra financiare e xxx group për UNIFI për pagesë të shumës prej 700.000 Euro, datë 3 shtator 2009;
- Komunikatë për shtyp nga UNIFI lidhur me nënshkrimin e parakontratës dhe informacioni i UNIFI-t dhe informacioni nga ViaOne;
- Shprehje e interesit nga ViaOne, datë 27 maj 2007;
- Korrespondencë XXX/B.D dhjetor 2007/janar 2008;
- Letër nga B.D/XXX duke informuar strukturën Dardafon LLC dhe marrja e licensës MVNO, datë 17 qershor 2008;
- Korrespondencë B.D/ART;
- Letër I.B/ART, datë 17 dhjetor 2007;
- Ftesa e XXX-së për MVNO, datë 3 tetor 2007;
- Memorandumi i bordit të ART-së, datë 29 maj 2008;
- Letër N.Rr;
- Dokumenti i bordit të XXX-së datë 11, 14, 15 dhe 22 korrik 2010;
- Përmbledhje e procesverbalit të takimeve të bordit të XXX-së, datë 14 gusht 2008, 4, 5, 16 dhe 22 shtator 2008, 2, 8, 14 dhe 20 tetor;
- Dokumenti i bordit të XXX-së datë 20 tetor 2008 i cili përmban raportin e Task Forces 2 rezolutën korresponduese të bordit;
- Përmbledhje e procesverbalit të takimeve të bordit të XXX-së, datë 22 mars 2010, përfshirë rezolutën e bordit të së njëjtës datë;
- Letër G.L./Bordi datë 7 gusht 2008 projekti për MVNO;
- Peticioni i Sindikatës së XXX-sw;
- Letër Gj./ICR, datë 5 nëntor 2008;
- Letër L./XXX BD;

- Letra të operatorëve Ovum Consulting Mobile Network, me shënime me shkrim dore;
- Raport i nënshkruar nga A.B;
- Paramarrëveshje MVNO XXX/Dardafon LLC draft 1, datë 25 gusht 2008;
- Paramarrëveshje MVNO XXX/Dardafon LLC, versioni 1 dhe versioni 2, datë 26 gusht 2008;
- Paramarrëveshje MVNO XXX/Dardafon LLC, datë 28 shtator 2008;
- Paramarrëveshje MVNO XXX/Dardafon LLC, datë 8 tetor 2008;
- Paramarrëveshje MVNO XXX/Dardafon LLC, datë, 15 dhjetor 2008, në dy versione njëra prej të cilave me Dardafon.net LLC;
- Marrëveshja përfundimtare MVNO XXX/Dardafon.net LLC, nënshkruar B.D dhe Sh.H;
- Parakontrata XXX/Dardafon LLC, nënshkruar nga B.D dhe Sh.H.;
- Transkripti verbatim i takimeve të bordit të XXX-së datë 2, 8 dhe 14 tetor 2008;
- Deklaratat financiare të auditimit/raport i XXX-së për vitet 2010 dhe 2011;
- Marrëveshja për blerje të aksioneve, datë 3 shtator 2009, me shtojca;
- Draft korniza e MVNO lëshuar nga ART;
- Raporti i mediave datë 15 dhjetor 2010 lidhur me aktivitetet SIM në SIM;
- Deklarata e A.Sh e cila konfirmon shitjen e aksioneve nga Dardafon LLC, datë 31 maj 2010;
- Pasqyra bankare e pagesës nga Xxx group tek Dardafon LLC lidhur me shpenzimet për licensën MVNO, datë 11 gusht 2008;
- Pasqyra financiare e depozitës prej 50.100 Euro nga Xxx tek Dardafon LLC, datë 11 gusht 2008;
- Deklaratat financiare të Dardafon.net LLC për vitin 2009 deri 2011;

- Prezantimi dhe pajtimi për pagesë për vitin 2010 dhe 2011 nga Dardafon.net XXX-së;
- Korrespondencë R.S/ S.R., datë 18 qershor 2008;
- Letër ART që aprovon kornizën rregulluese, datë 15 janar 2008;
- Korrespondencë e-mail e XXX/ART lidhur me konkuresit;
- Raporti ART mbi hetimin e brendshëm, datë 7 janar 2010;
- Korniza rregulluese ART mbi MVNO dhe vendimin e ART-së.

Dëshmitarët: deklaratat e dhëna në shqyrtim kryesor nga N.R, A.Y, E.P, M.Gj, B.K, A.B, G.L, S.A, S.R, G.R, D.H, M.K, F.B, A.M, Xh.S, E.P, Xh.R dhe N.A.

Dëshmitarët ekspertë: deklarata të dhëna në shqyrtim kryesor nga V.M, R.B, H.K dhe Zh.T. të paraqitura në mënyrë të plotë në dosjen zyrtare.

Raportet e ekspertëve: të datës 2 prill 2013 të nënshkruar nga H.K, R.B dhe Zh.T. të përcaktuar nga Gjykata bazuar në kërkesën e paraqitur nga Prokurori me datë 22 tetor 2012 nënshkruar nga J.O., P.P.A., C.J. dhe M.V., paraqitur nga Sh.D dhe avokati i tij mbrojtës Z. A.F. me datë 22 nëntor 2012.

Paraqitja e bazave

Bazat faktike:

a. Faktet relevante në vijim janë vlerësuar si të VERTETUAR:

Akuza 1

I.B, paraqitur mes datës 21 dhe 25 nëntor 2008 si përfaqësues ligjor i Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC, bazuar në marrëveshjen me dhe nën mbikqyrjen e B.D dhe Sh.D, ka paraqitur një parashtrësë pranë Agjencionit Rregullativ të Telekomunikimeve (ART) në Pristina me datë 25 nëntor 2008 për transferimin e licensës së operatorit MVNO nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC. Ai pretendoi përpara vendimmarrësve në ART se transferimi i licensës ishte bazuar në njohuri dhe pajtimin e pjesës më të madhe të aksionerëve të Dardafon LLC, Unitel World dhe xxxit të saj Z. A.Sh. Për shkak të parashtrësës së I.B, ART ka transferuar leicensën MVNO në besim nga Dardafon LLC tek Dardafon.net LLC, gjë që ka rezultuar në transferimin e licensës së Dardafon LLC.

Akuza 2

I.B bazuar në urdhrat nga dhe nën mbikqyrjen e B.D dhe Sh.D, ka përpiluar, nënshkruar dhe paraqitur kërkesën pranë ART-së. B.D dhe Sh.D kanë fituar kontrollin faktik për licensën MVNO duke e transferuar atë tek Dardafon.net LLC.

Akuza 4

B.D, Sh.D dhe I.B, në vend dhe kohë të papërcaktuar në vitin 2008 apo 2009, të paktën kanë ndikuar në përpilimin e tekstit të marrëveshjes përfundimtare të MVNO datë 16 janar 2009 mes XXX dhe Dardafon.net LLC. Në marrëveshje thuhet se Dardafon.net LLC ka arritur një "Parakontratë" në gusht 2008 me XXX, ndërsa në realitet kjo "Parakontratë" është arritur mes Dardafon LLC dhe XXX. Dardafon.net LLC nuk ka ekzistuar në gusht 2008. Marrëveshja përfundimtare MVNO është shkruar si specifikim dhe zhvillim i mëtejshëm i "Parakontratës" si pjesë integrale e marrëveshjes MVNO.

Akuza 6

Me datë 20 tetor 2008 në Prishtinë në takimin e bordit të drejtorëve të XXX-së, R.Gj si xxx të XXX-së ka votuar në favor – dhe pa reserva – të hyrjes së XXX-së në marrëveshjen MVNO me Dardafon.net LLC. Aprovimi ka paraparë që Dardafon .net LLC ka të drejtën si MVNO të përdorë burimet e XXX telekomunikime dhe në shkëmbim ka detyrim që të paguajë një pjesë të fitimit XXX-së, në shumën prej 22%. R.Gj e dinte se marrëveshja ishte bazuar në një propozim për ndarje të fitimit të cilin Bordi e kishte refuzuar më parë. Gj. ishte forca kryesore në Bordin e XXX-së për të aprovuar marrëveshjen MVNO. Sh.H si Xxx i XXX-së me datë 14 dhjetor 2008 ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare MVNO, datë 16 janar 2009, mes XXX dhe Dardafon.net LLC. Sh.H ka nënshkruar secilën faqe të marrëveshjes MVNO mes Dardafon.net LLC dhe XXX-së, përfshirë Shtojcën 7, e cila përmban "Parakontratën" mes Dardafon LLC dhe XXX. Për më tepër, Sh.H. ka nënshkruar marrëveshjen MVNO me një ndarje të fitimit prej 27% për XXX. Ai ka bërë këtë duke qenë në dijeni të rekomandimeve të kundërta të dhëna nga e ashtuquajtura Task Force 2. Task Force 2 ka arritur në përfundimin për një ndarje me të paktën 73% në favor të XXX-së.

Akuza 7

Sh.H ka nënshkruar marrëveshjen e përshkruar në akuzën 6 me Dardafon.net LLC dhe jo Dardafon LLC.

Akuza 10

Nuk ka

Gjithashtu faktet relevante në vijim rezultuan nga shqyrtimi kryesor:

Akuza 1, 2 dhe 4

Z. A.Sh, xxx i pjesës më të madhe të aksioneve të Dardafon LLC, Unitel World dhe xxxi i saj, ka shitur pozitën e tij në Dardafon LLC grupit Xxx në një datë të papërcaktuar jo pas datës 11 gusht 2008.

b. Faktet relevante në vijim janë vlerësuar si TË PAVERTETUAR:

Akuza 1

I.B ka pretenduar në mënyrë të rrejshme përpara vendimmarrësve të ART-së se transferimi i licensës ishte bazuar në njohurinë dhe pajtimin e pjesës më të madhe të aksionarëve të Dardafon LLC, Unitel World dhe xxxit të saj Zt. A.Sh.

Zt. Sh. nuk e ka ditur se ky transferim i licensës së MVNO do të bëhej dhe as nuk është pajtuar që licensa të transferohej tek Dardafon.net LLC.

Parashtresa pranë ART-së ishte e rrejshme dhe e pavërtetë gjë që ka rezultuar në humbjen e licensës nga Dardafon LLC apo ndonjë humbje financiare që tejkalon shumën 15,000.00 Euro.

Akuza 2

Transferimi i licensës nga ka rezultuar në dëm të rëndë për Dardafon LLC.

Akuza 4

B.D, Sh.D dhe I.B, në një vend dhe kohë të papërcaktuar në vitin 2008 apo 2009 kanë përpiluar vetë tekstin e marrëveshjes përfundimtare MVNO të datës 16 janar 2009 mes XXX-së dhe Dardafon.net LLC, duke ditur se në dokument ishin të përfshirë fakte të rrejshme.

Akuza 6

R.Gj ka ditur se marrëveshja përfshinte një ndarje të papranueshme të fitimit dhe mungesë të garancioneve të mjaftueshme për XXX-në, Marrëveshja e aprovuar paraqiste një ndarje të fitimit të pafavorshme dhe përmbajtje të pasigurtë.

Sh.H ka ditur se marrëveshja do të shkaktonte humbje financiare për XXX-në në një shumë të pallogaritshme e cila tejkalon shumën prej 100.000,00 Euro. Sh.H ka shkelur detyrimet e parakontratës me Dardafon LLC dhe ka ditur se ishte e pafavorshme dhe e pasigurtë duke bërë që XXX të mos ishte në gjendje të shmangte humbjet dhe duke shkaktuar dëm të madh XXX-së.

Akuza 7

Sh.H ka ditur se marrëveshja e përshkruar në akuzën 6 është ekonomikisht e pafavorshme për XXX-në dhe shkel detyrimet e parakontratës ndaj Dardafon.net LLC. Ai ka hyrë në këtë marrëveshje duke shkelur detyrimet e tij si SHE në mënyrë të tillë duke marrë presion nga burime të jashtme për të nënshkruar marrëveshjen MVNO në vend që të nënshkruante marrëveshjen bazuar në detyrat e tij ndaj XXX-së. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje ka rezultuar në humbje për Dardafon LLC që tejkalon 2,500.00 Euro dhe i ka siguruar Dardafon.net LLC një përfitim material që tejkalon 5.000,00 Euro.

Akuza 10

R.Gj. duke bërë presion në bordin e drejtorëve të XXX-së në tetor të vitit 2008 në Prishtinë për të aprovuar kontratën e lartpërmendur MVNO, ka tejkalu autoritetin e tij si xxx i Bordit dhe ka ushtruar ndikim të

pabazuar mbi anëtarët e bordit duke ditur se marrëveshja MVNO ishte e pafavorshme dhe duke ditur se pjesa më e madhe e anëtarëve të bordit përpara datës 20 tetor 2008 nuk kishte mbështetur mendimin e Task Forcës 1, Në këtë mënyrë R.Gj i ka dhënë Dardafon.net LLC një përfitim material i cili nuk pasqyronte mendimin e paimfluencuar të pjesës më të madhe të anëtarëve të bordit. Përveç një anëtari të bordit i cili ka mbështetur marrëveshjen MVNO pas rishqyrtimit të përqindjes së ndarjes së fitimit, ky kufizim është injoruar nga Gj. dhe si i tillë nuk është pasqyruar në vendimin e Bordit.”

I. Arsyetimi dhe gjetjet:

Gjatë tërë vlerësimit kritik të të gjitha provave të ofruara, Trupi gjykues ka shqyrtuar provat e lartpërmendura si në vijim: *(faktet e referuara janë paraqitur si ndihmesë në faqe 12 deri 15 të këtij aktgjykimi).*

Faktet e lartpërmendura që i referohen Akuzave 1, 2 dhe 4 që janë konsideruar si të vërtetuara janë dokumentuar në masë të madhe në dosjen e lëndës, respektivisht aplikacioni pranë ART i datës 25 nëntor 2008 për transferim të licencës së MVNO-së nga Dardafon LLC te Dardafon.net LLC. Përmbajtja dhe nënshkrimi i kësaj kontrate nuk janë kontestuar asnjëherë dhe vendimi i ART-së të aprovojë këtë aplikacion konfirmon faktet në tërësi. Fakti që B.D dhe Sh.D kanë qenë në dijeni lidhur me këtë aplikacion është e qartë që nga fillimi që është e evidente nga faktet e prezantuara nga mbrojtja e tyre si dhe nga faktet pasuese, respektivisht marrëveshja e mëparshme mbi transferimin e shumicës së aksionarëve nga Dardafon LLC dhe pagesa relevante drejt Zt. A.Sh më 11 gusht 2008, siç është dokumentuar në deklarin e A.Sh ku ka konfirmuar shitjen e aksioneve nga Dardafon LLC, në datën 31 maj 2010, pasqyrën financiare bankare të pagesës nga Xxx grup drejt Dardafon LLC lidhur me tarifën për licencën e MVNO-së, të datës 11 gusht 2008 dhe pasqyra financiare bankare për depozitën prej 50.100 euro nga Xxx drejt Dardafon LLC, më datën 11 gusht 2008. Për më shumë, marrëveshja përfundimtare mbi MVNO-në e datës 16 janar 2009 në mes të

XXX dhe Dardafon.net LLC i referohet Parakontratës së datës 8 gusht 2008 me XXX-në që nuk është në kundërshtim me datën e sipërpërmendur 11 gusht 2008, edhe pse jep indikacion për pasaktësi mbi palët e përfshira. Kjo pasaktësi mund të shpjegohet në dy mënyra: verzioni i prokurorisë, bazuar në pretendimet që janë paraqitur gjatë fazës së hetimeve nga Zt. A.Sh.; dhe verzioni i mbrojtjes i cili po ashtu mund të interpretohet nga ana e Trupit gjykues si i bazuar në përpjekje për të lehtësuar dhe shpejtuar procedurat burokratike të ART-së, duke e mbajtur transferin në mes të Dardafon LLC dhe Dardafon.net si jorelevant dhe në heshtje sa më shumë që është e mundur. Megjithatë, çdo efekt kolateral i mundshëm lidhur me shmangien nga tatimi janë jashtë qëllimit të këtij gjykimi.

Pas shqyrtimit të provave të paraqitura, Trupi gjykues nuk ka arsye të konsiderojë që letra e Zt. Sh. korrespondon me faktet e vërteta; Zt. Sh. asnjëherë nuk është ballafaquar me letrën gjatë shqyrtimit kryesor meqë ka qenë e pamundur për Trupin gjykues t'a ftojë atë si dëshmitar. Provat e jodrejtëpërdrejta që vijnë nga shtypi - Koha Ditore — duhet të konsiderohen si të papranueshme duke pasë parasysh se faktet e përmendura nuk kanë mund të ekzaminohen nga pala e kundërt në asnjë mënyrë. Për më shumë, pagesat e bëra A.Sh më 11 gusht 2008 që kanë lidhje koherente me letrën e A.Sh të datës 31 maj 2010 plotësisht mbështesin pretendimet e të pandehurve të përfshirë.

Prandaj, nuk ka prova që transferi i licencës, siç pohohet nga ART-ja, është bazuar në mënyrë të rreme në dijeninë apo pajtimin e A.Sh dhe ka formuar deklarata të rreme. Po ashtu nuk ka prova që A.Sh i është nënshtruar vlerës që tejkalon 15.000.00 euro, e as që i ka shkaktuar dëm të rëndë Dardafon LLC. Trupit gjykues nuk i janë paraqitur prova në mënyrë që të përcaktohet se kush ka përpiluar tekstin e marrëveshjes MVN0 përfundimtare me XXX-në të datës 16 janar 2009, përtej dijenisë së tyre të mëparshme dhe sipas udhëzimeve të B.D dhe Sh.D.

Sipas të dhënave dhe informacioneve të Agjencisë Kosovare për regjistrim të bizneseve, Dardafon.net LLC nuk ka ekzistuar para 8 gushtit 2008, mirëpo prapëseprapë ka qenë e përfshirë në pagesat e 11 gushtit 2008 siç është përmendur më lart.

Faktet e mësipërme që i referohen Akuzave 6, 7 dhe 10 janë shqyrtuar hollësisht dhe në mënyrë të mjaftueshme përmes një sërë deklaratash të të gjithë dëshmitarëve të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë qenë të përfshirë në procesin e votimit të Bordit të XXX-së duke iu referuar 20 tetorit 2008, dhe të cilët janë ballafaquar me procesverbalet e të gjitha seancave dëgjimore të mbajtura, në këtë datë ose më herët, siç është paraqitur në shqyrtim kryesor përpara Trupit gjykues.

Përmbajtja e të dy raporteve të Task Forcës 1 dhe 2 është e pakontestueshme dhe si të tilla nuk ngrehin ndonjë çështje sa i përket anëtarëve dhe aksioneve-profitit të propozuar.

Megjithatë, procesverbalet si dhe deklaratat e dëshmitarëve demonstrojnë asgjë tjetër pos disa rezervimeve bazuar në paaftësinë teknike për të marrë pjesë në vendim përtej aftësive të tyre profesionale, edhe pse duhet mbajtur mend që këta anëtarë të përfshirë në panel janë anëtarë që kanë të drejta të plota të vendosin në çështje sikur edhe Bordi i Drejtorëve të XXX-së. Të gjitha deklaratat e Gj. të përfshira në këto procesverbale mund të tregojnë për një presion për të pranuar marrëveshjen MVNO me Dardafon.net LLC por jo në mënyrë që mund të konsiderohet si e papranueshme, madje edhe si kryesues. Ia vlen të përmendet se asnjë ndikim i Gj. nuk është provuar lidhur me ndonjë përfshirje të mëhershme me raportin e Task Forcës 2. Duke pasur parasysh vlerësimin më të ri (Task Forca 2), nuk konsiderohet se është bërë presion i paligjshëm ndaj Bordit të Drejtorëve për të shpejtuar procedurat, duke mbajtur në mend se vetëm votimi përfundimtar vendos mbi çështjen. Nuk është vërtetuar se është ushtruar ndikim apo presion personal apo profesional mbi ndonjë nga drejtorët, si rezultat i deklaratave të dëshmitarëve të marrë në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor.

Për më shumë, Trupi gjykues ka analizuar bazat dhe përfundimet e të dy raporteve të ekspertëve të paraqitura përpara Trupit gjykues dhe nuk ka gjetur fakte vendimtare dhe/ose gjetje që kanë çuar deri te shkaktimi i dëmit XXX-së çfarëdo që të jetë vlera e saj, duke marrë parasysh perspektivën komerciale të kësaj marrëveshjeje MVNO, si dhe zhvillimet e saj në momentin e aplikimit të saj konkret në terren.

Lidhur me të pandehurin Sh.H, nuk është vërtetuar asnjë marrëveshje e fshehtë me Gj. (Akuza 6); nënshkrimi pasues i marrëveshjes MVNO më 16 janar 2009 mund të konsiderohet si asgjë por obligimi i tij ekzekutiv profesional si ShE lidhur me vendimin e mëhershëm të votuar nga Bordi i Drejtorëve prandaj nuk mund të konsiderohet vepër penale. Nuk është vërtetuar përmes asnjë mjeti provues të paraqitur përpara Trupit gjykues që H. ka qenë në dijeni për ndonjë humbje financiare të XXX-së që ka rezultuar nga marrëveshja MVNO pas ndonjë ndarje të papranueshme të profitit, të pafavorshëm apo të pasigurtë. Nuk është ofruar asnjë provë se, si ShE, ai është ndikuar nga presione të jashtme për të nënshkruar marrëveshjen MVNO.

Bazat ligjore:

Akuza 1

Sa i përket nenit 261.1 dhe 2 KPK (tani 335 i KPK të ri) një person duhet të shpallet fajtor për veprën penale të mashtrimit nëse “me qëllim për t’i sjellë vetes ... apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë ... së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër ...”

Një aplikacion i paraqitur para ART-së duke kërkuar transferimin e licencës MVNO nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC duke anashkaluar negociatat paraprake që kanë mbështetur këtë transfer por duke iu referuar atyre nëvend të kësaj nuk është një akt mashtrues në dëm të pronës së

Dardafon LLC apo të ART. Thjesht duke përmendur pranuesin e gabuar të transferit nuk do të dëmtonte pronën e ART-së apo Dardafon LLC meqë ka pasur një transfer paraprak dhe të vërtetuar të kësaj liçence drejt Dardafone.net LLC. Çdo problem i ngritur lidhur me këtë transfer paraprak gjithmonë mund t'i nënshtrohet një padie ligjore komerciale, civile nga natyra, por nuk provon vepër penale. Pos kësaj, kjo sjellje, siç pretendohet, mashtruese, gjithmonë mund të kontestohet nga Dardafon LLC - *rectius* nga Zt. A.Sh — përmes padisë civile, që do të thotë se aplikacioni nuk paraqet veprim mashtrues.

Prandaj, nuk është paraqitur asnjë provë për ndonjë veprim mashtrues nga ndonjë nga të pandehurit apo Prokuroria, që është element i domosdoshëm dhe fundamental ligjor. Në mungesë të tij, nuk është kryer asnjë vepër penale dhe lirimi i B.D, Sh.D dhe I.B. është pasojë e domosdoshme.

Akuzat 2 dhe 6

Në pajtim me nenin 237.1 dhe 2 të KPK personi kryen veprën penale të Lidhjes së Kontratës së Dëmshme nëse ai ose ajo si *“Personi i autorizuar ose përfaqësuesi i organizatës së biznesit apo personit juridik që ushtron veprimtari ekonomike dhe lidh kontratë për të cilën ... e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit ose për personin juridik ... dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit apo personit juridik ...”*

Specifikisht sa i përket Akuzës 2, nuk është e mundur të përfundohet se ndonjëri nga të pandehurit e përmendur kanë lidhur kontrata të dëmshme kur thjesht kanë aplikuar pranë ART-së për transfer të liçencës, meqë ky aplikacion nuk është fare kontratë. Për më shumë, vetë kontrata që ka mbështetur këtë aplikacion është vërtetuar para Trupit gjykues si ekzistente dhe nuk është vërtetuar ndonjë dëm i shkaktuar.

Asnjëra nga këto dy elemente ligjore nuk janë të pranishme dhe prandaj nuk ka vepër penale dhe lirimi është pasojë e domosdoshme.

Lidhur me Akuzën 6 dhe specifikisht me Gj., votimi në Bordin e Drejtorëve të XXX-së apo ushtrimi i presionit mbi ndonjë nga anëtarët e tij për të votuar në favor nuk provon kontratën dhe në vetvete fare nuk ka efekt detyrimor. Kjo është e mjaftueshme për mos-ekzistimin e kësaj vepre penale dhe lirimin e tij të domosdoshëm.

Lidhur me H., duke marrë parasysh se nuk është ofruar asnjë provë mbi ndonjë marrëveshje të fshehtë me Gj., H. nuk ka mundur të jetë në dijeni për ndonjë natyrë të dëmshme të kontratës e cila nuk është provuar të jetë e dëmshme. Kjo mjafton që të konstatohet se vepra penale nuk ekziston dhe të lirohet H. lidhur me këtë Akuzë meqë vetëm thjesht qëllimi, edhe nëse ekzistues, nuk mjafton që kjo vepër penale të justifikohet nga ana ligjore.

Akuza 4

Sa i përket nenit 332.1 dhe 3 dhe 333.1 të KPK (tani 399 i KPK të ri) personi kryen veprën penale të përkufizuar si falsifikim i dokumenteve nëse ky person, *“Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar ... nëse ky person mashtron një person tjetër lidhur me përmbajtjen e çfarëdo dokumenti dhe një person i tillë nënshkruan dokumentin duke menduar që ai ... është duke nënshkruar një dokument tjetër ose një dokument me një përmbajtje tjetër”*.

Vlen të përmendet se marrëveshja përfundimtare MVNO i referohet Parakontratës të datës gusht 2008 të lidhur në mes të Dardafon.net LLC dhe XXX ku është lidhur në mes të Dardafon LLC dhe XXX. Megjithatë, ky ndryshim i vogël nuk ka ndonjë efekt mashtrues për XXX-në. Një lidhje e domosdoshme në mes të referimit të rremë dhe vendimit për të nënshkruar nga XXX-ja duhet të demonstron në mënyrë që të provohet veprimi mashtrues, dhe kjo nuk është bërë. Duhet të vërtetohet qëllimi i provuar dhe prandaj, sa i përket fakteve në fjalë, kjo po ashtu nuk është

provuar fare. Lidhur Dardafon LLC, nuk është vërejtur asnjë efekt mashtrues, meqë është provuar transferi i mëparshëm i aksionarëve. Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, vepra penale nuk është provuar nga ana faktike dhe ligjoreprandaj lirimi është pasojë e domosdoshme.

Akuza 7 dhe 10

Në pajtim me nenin 339.1 dhe 3 KPK një person kryen veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare kur ai/ajo në cilësinë e *“një person zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të paligjshëm material për vete apo për një person tjetër apo një organizatë biznesi, shpërdoron ... pozitën e tij zyrtare ... apo nuk përmbush ... detyrat e tij zyrtare ...”*

Lidhur me akuzën 7, si SHE i XXX-së dhe me një nënshkrim të thjeshtë për marrëveshjen MVNO pas një vendimi të nxjerrë nga Bordi i Drejtorëve, qëllimi i H. për të shkaktuar ndonjë dëm XXX-së nuk është vertetuar edhe nëse ai është në dijeni të ndonjë raporti të mëparshëm të Task Forcës 1. Nuk është vertetuar ndonjë presion nga jashtë lidhur me rezultatin në nënshkrimin e lartpërmendur. Për më tepër nuk është vertetuar as dëmi i shkaktuar ndaj Dardafon LCC.

Mosekzistenca e kësaj vepre penale si e kryer nga H. është e qartë dhe lirimi i tij është pasoja e nevojshme lidhur me këtë akuzë.

Lidhur me akuzën 10, nuk ka prova domethënëse që tregojnë presion të jashtëligjshëm apo ndikim të pabazuar të ushtruar mbi anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe/ose në vendimin e tij përfundimtar. Për më tepër, raporti i Task Force 2 nuk është vertetuar si i influencuar nga ai dhe bie në kundërshtim me përfundimet e arritura nga Task Force 1. Për më tepër, as dëmi i shkaktuar ndaj Dardafon LCC nuk është vertetuar gjë që hedh poshtë pretendimet lidhur me qëllimin e tij të supozuar për të shkaktuar dëm. Mosekzistenca e kësaj vepre penale si e kryer nga H. është e qartë dhe lirimi i tij është pasoja e nevojshme lidhur me këtë akuzë.

Duke pasur parasysh bazat e lartpërmendura u vendos si në dispozitiv.

Mjeti ligjor: Prokurori dhe/apo palët e dëmtuara mund të parashetrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore në Prishtinë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur aktgjykimi i plotë me shkrim i është dorëzuar palëve, në pajtim me nenin 398, paragrafin 1 të KPPK-së, nëse shpallet në mënyrë të duhur brenda 8 (tetë) ditësh nga data më poshtë.

Prishtinë 28 qershor 2013

Vitor Hugo Pardal

Kryetar i Trupit gjykues

Jacqueline Ryan

Procesmbajtës